



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 mars 2021
Nr. ref.:RK 1719/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI213/19

Parashtrues

Atdhe Dema

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit
të Gjykatës Supreme të Kosovës, CML. nr. 11/2019, i 9 shtatorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Atdhe Dema, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) CML. nr. 11/2019, të 9 shtatorit 2019. Përmes Aktgjykimit të kontestuar ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 3475/18 të 28 dhjetorit 2018 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.2504/19 të 31 majit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu, në substancë, ngre pretendime për shkelje të drejtës për një gjykatë të paanshme siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 25 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 27 nëntor 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Remzie Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

8. Më 17 janar 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 23 tetor 2020, Gjykata e njoftoj portalin Insajder për regjistrimin e kërkesës dhe për mundësinë që të paraqes komente lidhur me rastin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
10. Më 13 nëntor 2020, Insajderi dorëzoi në Gjykatë komentet përkatëse.
11. Më 10 dhjetor 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.
12. Më 3 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Nga shkresat e lëndës rezulton se emri i parashtruesit të kërkesës ishte i përfshirë në një shkrim të publikuar nga portali Insajder, i cili titullohej si në vijim: *“Prokurori që ia fali mbi 29 mijë euro Afrim Muçiqit avancohet në Prokurorinë Speciale”*. Ky titull sipas parashtruesit të kërkesës është i bazuar në të pavërteta dhe si i tillë publikimi i këtij shkrimi dëmton reputacionin e tij.

Vendimmarrja në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës

14. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ishte ankuar tek Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KMSHK), kundër gazetës online Insajder për shkrimin *“Prokurori që ia fali mbi 29 mijë euro Afrim Muçiqit avancohet në Prokurorinë Speciale”* duke pretenduar se shkrimi i cekur dëmton reputacionin e tij me të pavërteta, ndërsa me shkrimin e botuar, Insajderi ka bërë shkeljen e Kreut II (Raportimi i së vërtetës), dhe Kreut IV (e drejta për t’u përgjigjur) të Kodit të Mediave të Shkruara.
15. Më 5 shkurt 2019, Kuvendi i KMSHK shqyrtoi ankesën dhe provat e prezantuara, me ç’rast konstatoi se Insajderi në lajmin e publikuar ka kryer shkelje të pjesshme të Kodit të Mediave të Shkruara duke shkelur Kreun II (Raportimi i së vërtetës), pasi që KMSHK konstatoi se ka pasaktësi në faktet e prezantuara në shkrim. Ndërsa nuk ka shkelje të Kreut IV (E drejta për t’u përgjigjur) pasi që përgjigja me shkrim e parashtruesit të kërkesës është përfshirë në tekstin e shkrimit.

Procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta

16. Më 26 nëntor 2018, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për caktim të masës së sigurisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) duke kërkuar të tërhiqet shkrimi dhe titulli i lartcekur nga portali Insajder përmes vendosjes së masës së sigurimit me arsyetimin se

reputacioni i parashtruesit të kërkesës është duke u dëmtuar. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që të detyrohet pala e paditur që t'ia kompensojë dëmin jo material në shumë prej 50.000,00 euro, për shkak të humbjes së reputacionit nga shkrimi i pavërtetë kundër tij.

17. Më 28 dhjetor 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit C.nr.3475/18, refuzoi kërkesën e parashtruesit për vendosjen e masës së sigurisë me arsyetimin se propozimi për vendosjen e masës së sigurisë gjatë asaj faze gjyqësore ishte i pabazuar. Ndër të tjera, Gjykata sqaroi se propozim i parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë nuk i plotësonte kushtet ligjore të nenit 297 të Ligjit nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK).
18. Për më tepër, Gjykata Themelore sqaroi se nuk ka vlerësuar nëse shkrimi i publikuar nga Insajder është si rezultat i ndonjë hulumtimi profesional apo nëse ky i fundit është tendencioz dhe fyes. Por, Gjykata Themelore arsyetoi se për këtë çështje do të vendoset në merita sipas kërkesëpadisë dhe në rast se shkrimi i publikuar me përmbajtje shpifëse rezulton që i ka shkaktuar dëm reputacionit të parashtruesit të kërkesës, atëherë këtij të fundit do t'i kompensohet dëmi.
19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit C.nr.3475/18 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 21 shkurt 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac.nr.666/19 e aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, shpalli të pavlefshëm Aktvendimin C.nr.3475/18 të Gjykatës Themelore dhe e ktheu rastin për rigjykim në shkallë të parë.
21. Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj arsyetoi me sa vijon: *“Gjykata e shkallës së parë fare pa i hetuar dhe analizuar faktet, merr aktvendimin e atakuar përmes të cilit e refuzon propozimin e paditësit-propozuesit të sigurimit, për caktimin e masës së sigurisë se propozuar. Gjykata e shkallës së parë ka mundur që për sqarimin e rrethanave kontestuese, të administroj edhe provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës për ta konstatuar saktë gjendjen faktike ashtu siç kanë pretenduar palët në procedurë. Andaj gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk e ka sqaruar mjaftueshëm dhe bindshëm gjendjen faktike të rastit në fjalë, ku vetëm pas sqarimit të këtyre rrethanave, gjykatat pastaj do të kishte mundësi që të vlerësoj bazueshmërinë e propozimit të paditësit-propozuesit të sigurimit për caktimin e masës së sigurisë, apo refuzimin e saj [...].”*
22. Më 8 prill 2019, Gjykata Themelore në rivendosje përmes Aktvendimit C.nr.3475/18 refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se propozimin për vendosjen e masës së sigurisë nuk i plotëson kushtet e kërkuara me nenin 297 të LPK-së. Ndër të tjera, Gjykata Themelore theksoi *“Gjykata vlerëson se në këtë rast edhe përkundër ekzistimin të të drejtës subjektive për paditësin, nuk ekziston rreziku se pa caktimin e kësaj mase të*

sigurimit do ti pamundësohej apo vështirësohej realizimi i kërkesës së propozuesit, ngase me asnjë prove nuk është arritur që të provohej një ekzistim i rrezikut të tillë [...].”

23. Për me tepër, Gjykata Themelore në Aktvendimin e saj theksoi “[...] detyrimi eventual për tërheqjen e artikullit nga publikimi rezulton me cenimin e të drejtës për lirën e shprehjes, ndërsa kjo është parakusht në një shoqëri demokratike, dhe se në rastin konkret dhe në raste të tilla, po të ndërhyhej në punën dhe veprimtarinë e gazetarisë, atëherë do kishim edhe cenim të normave kushtetuese, konkretisht të nenit 40 të Kushtetues së Republikës së Kosovës [...]”
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të të drejtës materiale.
25. Më 31 maj 2019, Gjykata e Apelit, duke vepruar në rigjykim nxori Aktvendimin Ac.nr.2504/19 dhe vërtetoi Aktvendimin C.nr.3475/18 të Gjykatës Themelore të 8 prillit 2019 me arsyetimin se kërkesa e parashtruesi të kërkesës nuk kishte plotësuar kushtet e kërkuara nga neni 297 i LPK-së.
26. Në një datë të paspecifikuar, me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, Prokurori i Shtetit parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit Ac.nr.2504/19, të 31 majit 2019 të Gjykatës së Apelit. Në kërkesën e tij, Prokurori i Shtetit pretendoi se Aktvendimi i lartpërmendur i Gjykatës së Apelit karakterizohet me shkelje të të drejtës materiale.
27. Më 9 shtator 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit CML.nr.11/2019 refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit dhe vërtetoi aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët me arsyetimin se propozimi i parashtruesi të kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë nuk i kishte plotësuar kushtet e kërkuara nga paragrafi 2 i nenit 16 të Ligjit Nr. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes.
28. Gjithashtu, Gjykata Supreme në Aktvendimi e saj shpjegoi se liria e shprehjes mund të kufizohet vetëm me anë të ligjit kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokim të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Gjykata Supreme tutje kishte shpjeguar se gjykatat e instancës më të ulët në pajtim me nenin 306 pika 1 të LPK-së, kanë pasur mundësi porse nuk kanë qenë të detyruara që të caktojnë masë të përkohshme dhe me të drejtë bazuar në nenin 306 të LPK-së kanë njoftuar palën kundërshtare, kanë caktuar seancë dëgjimore dhe kanë refuzuar masën e propozuar, pasi që kanë konstatuar se nuk ekzistojnë kushtet për caktimin e saj.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi CML. nr. 11/2019 i Gjykatës Supreme i 9 shtatorit 2019, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës.
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim: *“Vendimet e kundërta të gjykatave prekën dinjitetin tim në një mënyrë flagrante, sidomos kur nuk u vendos sipas propozimit tim për përcaktimin e një urdhri gjykate, por u vendos për një kërkesë që unë nuk e kërkoja, një propozim, pra një propozim për përcaktimin e një mase sigurie.”*
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Me aktvendimet e kundërshtuara nuk bëhet dallim mes masës së përkohshme dhe masës së përkohshme të sigurisë. Dallimi mes këtyre dy termeve paraqitet edhe në dispozitën e nenit 310 të LPK kur në paragrafin 1 është parashikuar e drejta e ankesës kundër aktvendimit mbi masën e sigurimit, por jo edhe e drejta e ankesës mbi masën e përkohshme. Nga ana tjetër ligji civil mbi shpifjen dhe fyerjes, paraqet ligj special krahasuar me Ligjin për procedurën kontestimore, që nënkupton zbatimin e këtij ligji e jo të dispozitës nga neni 207 i LPK.”*
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“Aktvendimet e kundërshtuara nuk vërtetuan fare faktin se artikulli i kontestuar të cilit i është bashkangjitur edhe fotografia e propozuesit me qëllim që opinioni të njihet me identitetin edhe me tij, e jo vetëm me veprimin e tij dhe i cili është i përshtatshëm për lexim dhe shikim në tërë botën, cenon apo jo dinjitetin e propozuesit apo mund të cenoi apo jo dinjitetin e tij, aq më tepër kur shpifet për veprim të paligjshëm nga vendi dhe detyrat e punës dhe se është person familjar.”*
33. Për sa i përket balancimit të së drejtës së parashtruesit të kërkesës nga neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] karshi të së drejtës të palës kundërshtare nga neni 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pohon: *“Duke zbatuar kështu ligjin gabimisht në dëm të propozuesit, praktikisht arrihet në përfundim logjik se shkrimi i kontestuar i bazuar në të pavërteta, nga ana e gjykatave vlerësohet shprehje e mendimit të lirë, ndërsa aprovimi i propozimit për caktimin e masës së përkohshme do të paraqite rrezikim të shprehjes së mendimit të lirë, në kundërshtim me dispozitën kushtetuese nga neni 40 dhe nenin 10 të Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut, ose shprehur më thjesht sipas aktvendimeve të kundërshtuara praktikisht rrjedh se shprehja e lirë nuk duhet sanksionuar (në rastin konkret ndaluar nga qarkullimi), edhe pse është bazuar në të pavërteta.”*
34. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pohon se *“Me aktvendimet e kundërshtuar gabimisht zbatohen dispozita nga neni 40 i Kushtetutës dhe neni 10 i Konventës Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut. Neni 16 i Ligjit civil për shpifje dhe fyerje me aktvendimin e Gjykatës Supreme gjithashtu është zbatuar gabimisht duke u thirr në krijimin e kushteve kumulative për të bërë të bazuar propozimin.”*

35. Parashtruesi i kërkesës po ashtu, në substancë, ngre pretendime për shkelje të së drejtës për një gjykatë të paanshme. Parashtruesi i kërkesës pohon: *“Gjykata e Apelit me Aktvendimin e saj AC.nr.666/19 datë 21.2.2019, me të cilin ka anuluar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë [...] ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për kërkesë inekzistente [...] por me aktvendimin e mëvonshëm të saj Ac.nr.2504/19 datë 31.05.2019, për të njëjtat shkelje, në gjendje faktesh të njëjta, pa mos nxjerrur prova tjera, e refuzon ankesën dhe vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë edhe pse në të dy rastet kolegji ka qenë i përbërë nga gjyqtarët e njëjtë.”*
36. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata: *“Unë kërkoj nga Gjykata Kushtetuese të vërtetoj se vendimi i Gjykatës Supreme dhe shkallëve më të ulëta shkelin të drejtat dhe liritë e mia në një mënyrë flagrante, të drejtën e dinjitetit [...]”*

Komentet e dorëzuara nga pala e interesuar "Insajder"

37. Më 13 nëntor 2020, Insajderi dorëzoj në Gjykatë komentet e tij lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Sipas Insajder, shkrimi i publikuar ishte i bazuar në dokumentet e institucioneve publike autenticiteti i të cilave nuk kontestohet dhe se gjatë publikimit të shkrimit në tërësi janë respektuar procedurat për raportimin e të vërtetës dhe dhënies së mundësisë së personave të adresuar për reagim dhe plotësim të shkrimit. Më tutje, sipas Insajder, shkrimi i publikuar është i bazuar në tre dokumente zyrtare a) Raportin e Administratës Tatimore të Kosovës; b) Kallëzimin Penal i deponuar në Prokurori; dhe në c) Dosjen hetimore të Prokurorisë mbi personat e adresuar në shkrim. Në fund, Insajder i propozon Gjykatës që kërkesën e parashtruesit të kërkesës ta refuzojë si të papranueshme.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 297

297.1 Masa e sigurimit mund të caktohet:

a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe

b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte

gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

297.2 Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me Ligjin mbi Procedurën Përmbartimore, jep garanci në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit.

297.3 Po që se propozuesi nuk jep garanci brenda afatit të caktuar gjykata e refuzon propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta liroj atë nga detyrimi i dhënies së garancisë po që se konstatohet se nuk ka mundësi financiare për një gjë të tillë.

297.4 Bashkësitë e pushtetit lokal janë të përjashtuara nga detyrimi i paragrafit 3 të këtij neni.

Ligji NR. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes

Kapitulli II

MASAT PËR MBROJTJEN NGA SHPIFJA DHE FYERJA

Neni 4

Veprimi kundër shpifjes dhe fyerjes

4.1. Një person ka të drejtë të kërkojë përmes procedurës gjyqësore të ndalë shpifjen dhe fyerjen dhe premtimin se shpifja apo fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen, tërheqjen e informacionit shpifës apo fyes ndaj personalitetit të tij/saj dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.

4.2. Në qoftë se shpifja dhe fyerja është kryer përmes një mediumi masiv, patjetër duhet të demantohet në të njëjtin medium masiv dhe ti ipet rëndësia e njëjtë. Përgënjeshtrimi do të publikohet brenda tetë (8) ditëve pas pranimit të kërkesës relevante në rastin e gazetave ditore dhe në të njëjtën faqe ku është publikuar shpifja dhe fyerja, në botimin e ardhshëm të një botimi periodik apo një agjencie telegrafike dhe brenda tetë (8) ditëve në të njëjtën mënyrë ose në të njëjtën kohë të ditës në rastin e informacionit të transmetuar.

4.3. Në rastin kur informacioni shpifës ose fyes është i drejtuar ndaj një fëmije, prindi ose kujdestari i tij ligjorë mund të inicojë procedurën kundër shpifjes dhe fyerjes para gjykatës kompetente sipas këtij Ligji.

4.4. Në rastin kur informacioni shpifës ose fyes është i drejtuar ndaj një të vdekuri, trashëgimtari i shkallës së parë të tij mund të inicojë procedurën kundër shpifjes dhe fyerjes para gjykatës

Kapitulli III *PËRGJEGJËSIA*

Neni 5 *Përgjegjësia për shpifje dhe fyerje*

5.1. Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.

5.2. Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj.

5.3. Kur shpifja ose fyerja ka të bëjë me një çështje të interesit publik ose kur personi i shpifur ose fyer është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për një pozitë publike, mund të ketë përgjegjësi për shpifje ose fyerje vetëm nëse autori ka ditur se informacioni ka qenë i rrejshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij.

5.4. Autoritetet publike ndalohen nga paraqitja e kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publikë mund të paraqesin kërkesë për kompensim e dëmit nga shpifja apo fyerja privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal.

Kapitulli IV *RASTET E PËRJASHTIMIT NGA PËRGJEGJËSIA DHE KUFIJTË E* *PËRGJEGJËSISË*

Neni 6 *Prova e të vërtetës*

6.1. Në të gjitha veprat për shpifje dhe fyerje, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik, i padituri do të ketë barrën e provave për të dëshmuar vërtetësinë e deklaratës së tij dhe konstatimi nga gjykata se një nga deklaratat e fakteve që vihen në dyshim është në thelb e vërtetë e përjashton të paditurin nga çdo përgjegjësi.

6.2. Në veprat e shpifjes dhe fyerjes që përfshijnë deklaratat të një interesi publik, i padituri do të mbajë barrën e provave se ai/ajo ka vepruar me përgjegjësi në publikimin e deklaratës. Konstatimi nga gjykata se i padituri ka vepruar me përgjegjësi në publikimin e deklaratës, do të përjashtojë të paditurin nga çdo përgjegjësi, përveç nëse i padituri ka ditur se deklaratat ka qenë e rrejshme apo ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e deklaratës.

Neni 7 *Publikimet e arsyeshme*

Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mire, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla.

Neni 8
Opinionet

Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të cilën gjykata e ka vlerësuar të jetë një deklaram i opinionit, me kusht që opinionin të jetë shprehur me qëllim të mirë dhe të jetë bazuar në ndonjë fakt.

Neni 16
Urdhëresat Gjyqësore

16.1. Një person ka të drejtë të kërkojë në procedurën gjyqësore të ndalet shpifja dhe fyerja dhe tërheqjen e informacionit shpifës dhe fyes lidhur me personalitetin e tij/saj si dhe premtimin se shpifja dhe fyerja nuk do të përsëritet në të ardhmen përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj.

16.2. Urdhëresat gjyqësore paraprahe për të ndaluar përhapjen apo përhapjen e mëtejshme të informacionit, mund të lëshohen vetëm kur publikimi tanimë është kryer dhe kur personi që pretendohet të jetë i dëmtuar mund të sigurojë se informacioni i ka shkaktuar dëm reputacionit të tij apo të saj, dhe se individ i pretendohet të jetë i dëmtuar do të pësojë dëmtim të pazëvendësueshëm si rezultat i përhapjes së mëtejshme.

16.3. Urdhëresat gjyqësore të përhershme për ndalimin e përhapjes apo përhapjes së mëtejshme, mund të aplikohen vetëm ndaj shprehjeve specifike që konstatohet se janë shpifëse apo fyese dhe ndaj autorëve ose medimeve masive specifike të cilat kryejnë ose përhapin shprehjen.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
39. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

40. Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet: 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

41. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [CML.nr.11/19] të 9 shtatorit 2019, pas shterimit të mjeteve juridike lidhur me caktimin e masës së sigurisë, çka ka qenë objekt shqyrtimi kryesor në procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta. Për sa i përket pretendimeve për cenim të dinjitetit nga 23 i Kushtetutës dhe shkelje të së drejtës për një gjykatë të paanshme të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk kanë qenë objekt shqyrtimi nga gjykatat e rregullta, për çka janë refuzuar të papranueshme për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike bazuar në arsyetimin e dhënë në tekstin e mëposhtëm.
42. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të

Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

43. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (1) (b) dhe (2) i Rregullores së punës përcakton që:

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]*

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

44. Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës mund të përmbliidhen si në vijim: (i) pretendimi për zbatimin e ligjit të gabuar në lidhje me caktimin e masës së sigurisë ndaj artikullit të portalit Insajder; (ii) pretendimi për cenim të dinjitetit të garantuar me nenin 23 të Kushtetutës; dhe, (iii) pretendimi për shkelje të së drejtës për një gjykatë të paanshme të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

Pretendimi për zbatim të ligjit të gabuar

45. Gjykata vëren që Gjykata Supreme e kishte refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit kundër aktvendimeve të gjykatave të rregullta, përmes të cilave, gjykata e rregullta refuzuan propozimin e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë (urdhëresën gjyqësore). Gjykata Supreme i kishte vlerësuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët të drejta dhe të bazuara në ligj.
46. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta është dashur të zbatonin dispozitat e ligjit civil mbi fyerje dhe shpifje në vend të dispozitave të LPK-së, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet faktike ose ligjore që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata nuk mund t'i vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë shtyrë gjykatën e rregullt të merr një vendim në vend të tjetrit. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata atëherë do të vepronte si gjykatë e shkallës së tretë ose të katërt, gjë që do të paraqiste mosrespektimin e kufijve të cilat janë të imponuara me juridiksionin e saj. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Perlala kundër Greqisë*, nr. 17721/04, Vendimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 25).
47. Gjykata vëren se refuzimi i propozimit të parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit dhe kërkesës së tij si tërësi nga gjykatat e rregullta ka më

tepër të bëj me mos plotësimin e kushteve siç kërkohet me nenin 297 të LPK-së dhe me mos ofrimin e provave relevante për dëmin e shkaktuar. Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta në substancë kanë trajtuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe fakti se kërkesa e parashtruesit është refuzuar nuk nënkupton se cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Gjykata po ashtu vlerëson se bazuar në parimin *iura novit curia* u takon gjykatave të rregullta që të përcaktojnë se cili ligj dhe mënyra se si zbatohet ai në rrethanat e rasteve nën juridiksionin e tyre, përveç nëse me ligjin e zbatuar në mënyrë flagrante janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, çfarë nuk ka ngjarë në rrethanat e rastit nën shqyrtim.

48. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit të saj C.nr.3475/18, të 28 dhjetorit 2018, kishte vlerësuar:

“Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve në procedurë dhe duke iu referuar kërkesës ligjore nga neni 297 pika a) dhe b) të LPK -së në ndërlidhje me dispozitat e Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes, gjeti se propozimi për caktimin e masës - tërheqjes se artikullit, në këtë fazë të procedurës nuk është i bazuar, meqë nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 227 paragrafi 1 b) të LPK-së- për caktimin e masës së sigurisë, e cila dispozite përcakton se: Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bene të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës se këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë se vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Në këtë kuptim gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e vërtetësisë se përmbajtjes se artikullit të publikuar nëse i njëjti është rezultat i hulumtimit të mjaftueshëm dhe profesional, i bazuar në etiken nga fusha e gazetarisë, apo shkrimi është tendencioz apo fyes, sepse gjykata konsideron se për këtë çështje do të vendoset meritorisht sipas kërkesëpadisë dhe në rast se do të rezulton se artikulli, për shkak të përmbajtjes eventuale të informacionit shpifës, i ka shkaktuar dëm propozuesit, gjegjësisht paditësit në atë situatë, paditësit mund t'i gjykohej shuma e caktuar në emër të kompensimit të dëmit. Sidoqoftë në këtë fazë të procedurës, gjykata vlerëson se detyrimi eventual për tërheqjen e artikullit nga publikimi, rezulton me cenimin e të drejtës për lirinë e shprehjes, ndërsa kjo është parakusht në një shoqëri demokratike. Në këtë kontekst gjykata përkujton se sipas Ligjit kundër shpifjes dhe fyerjes përcaktohet se ligji në fjalë interpretohet në mënyrën e cila siguron se aplikimi i dispozitave të tij e maksimalizon parimin e lirisë se shprehjes dhe do të jetë në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si zbatohet në praktikën ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [...] Kundër propozuesit, përmes përfaqësuesit të autorizuar si ne parashtruesin me shkrim të datës 10.12.2018, ashtu edhe në seancën dëgjimore të datës 19.12.2018, kanë kundërshtuar si të pabaze propozimin për caktimin e masës së sigurisë _me arsyetimin se nuk argumentohen dy kushtet

kumulative nga neni 297 i Ligjit për Procedurën kontestimore (LPK) për lejimin e caktimit të masës së sigurisë. Sipas parashtrimeve të kundër propozuesit; e gjithë përmbajtja e shkrimit është e vërtetë dhe bazohet në dokumente zyrtare, sikurse janë raportet e ATK-se, të cilat dëshmojnë se propozuesi nuk e ka marrë për bazë raportin përfundimtar të ATK-se me të cilin këngëtarin AM ngarkojnë me rreth 45,000.00 €, shmangie nga tatimi. Në përgjigjen e propozuesit dhënë edhe ATK-se por edhe mediumit të kundër propozuesve ka qenë se ai vet kishte bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë për këngëtarin dhe se nuk mund të merr parasysh raportin e dytë të ATK-se, sepse i njëjti ishte i vonuar. Në këtë rrethanë rezulton se prokurori nuk ka përmbushur detyrat e tij gjë që efektivisht ka rezultuar me lirimin nga përgjegjësia të këngëtarit AM për pagesën e shumës prej 29,000.00 €, e cila përbënë diferencën në mes të shumës në 15,000.00 €, për të cilën ai ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë me propozuesin dhe shumës 45,000.00 €, të cilën është detyrë të paguaj po që se prokurori do të përmbushte detyrimet e tij.”

49. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac.nr.2504/19 të 31 majit 2019, kishte sqaruar:

“Kushtet e kërkuara sipas kësaj dispozite duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe jo alternative. Më të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vepruar kur ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, sepse në rastin konkret sidomos kushti i dytë që ka të bëjë me ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës në fjalë, propozuesit do t'i pamundësohej apo vështirësohej realizimi i të drejtës së tij subjektive nuk është plotësuar. Kjo ka të bëjë me faktin se shkrimi në fjalë është botuar/publikuar nuk është riprodhuar, madje deri me tani nga ana e të paditurve nuk është ri publikuar apo modifikuar shkrimi në fjalë në çfarëdo mënyre. Shkrimi në fjalë është publikuar njëherë, ka mbetë si i tillë. Dëmi që ka pasur mundësi të shkaktohet është shkaktuar dhe i njëjti nuk është në rritje, pastaj nuk vihet në rrezik realizimi i të drejtës subjektive të paditësit, pa lëshimin e masës, pasi kërkesa kryesore nga padia është kompensimi i dëmit në emër të shpifjes, e që nuk ka asnjë element që e vendos në pikëpyetje këtë fakt në të ardhmen sa paku nga provat e administruara ashtu siç janë. Në raport me kushtin e parë ky kusht pjesërisht është plotësuar nëse i referohemi gjendjes momentale, por në rastin konkret meqenëse sipas LPK-së kërkohet plotësimi i kushteve në mënyrë kumulative kërkesa apo propozimi për masë me të drejtë është refuzuar. Vendimi për refuzimin e masës së sigurimit të propozuar nga paditësi/propozuesi, në asnjë mënyrë nuk e prejjudikon çështjen kryesore dhe se gjykata e shkallës së parë është e obliguar që të shqyrtoj provat dhe faktet në tërësi në përputhje me ligjin dhe në fund të del me një epilog të drejtë dhe të saktë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Masa e sigurimit sikurse paraqet mënyrë të të siguruarit të kërkesëpadisë për palën paditëse, nëse e njëjta lëshohet pa u plotësuar kushtet paraqet kufizim për palën tjetër, ndërsa kufizimet duhet të jenë vetëm në bazë të ekzistimit të arsyejeve ligjore të cekura si më lartë, përndryshe cenojnë të drejta tjera [...] Vendimi i Këshillit të Mediave të Shkruara në raport me propozimin e masës së sigurimit nuk

është provë e mjaftueshme për të vërtetuar plotësimin e kushteve ligjore në drejtim të aprovimit të propozimit të për lëshimin e masës së sigurimit [...] ”.

50. Në fund, Gjykata i referohet pjesës relevante të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, CML.nr.11/2019 të 9 shtatorit 2019, që shpjegon:

“Në rastin konkret Gjykata Supreme pajtohet në tërësi me qëndrimin e dy gjykatave të lartpërmendura se nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga paragrafi 2 të nenit 16 të Ligjit të lartë përmendur [Ligji NR. 02/L-65 Ligji Civil Kundër Shpifjes Dhe Fyerjes] për lëshimin e urdhërësës gjyqësorë, nga se shkrimi i publikuar nuk është përsëritur apo modifikuar në asnjë mënyrë por ka mbetur si i tillë, pastaj dëmi që paditësi eventualisht ka pësuar është shkaktuar dhe i njëjti nuk është në rritje, ngase kundër tij nuk është iniciuar asnjë lloj procedure si pasoje e këtij shkrimi, i njëjti është avancuar në një funksion gjyqësor jashtëzakonisht të respektueshëm, Prokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Kështu që në asnjë mënyrë nuk vihet në rrezik realizimi i të drejtës subjektive të paditësit, pa lëshimin e masës së kërkuar nga ai, kështu që edhe Gjykata Supreme përfundon se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 16 i këtij ligji për lëshimin e masës së propozuar [...] Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson, sikur edhe gjykata e shkallës së parë dhe e dytë se me refuzimin e propozimit për masën e propozuar nga paditësi, nuk është cenuar liria shprehjes e parapare me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, kjo ngase në këtë dispozitë të kësaj Konvente është proklamuar po ashtu e drejta e lirisë së shprehjes dhe së ushtrimit të lirisë së shprehjes mund të kufizohet me ligj nëse është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, etj., si dhe për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të tjerëve, por sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjithnjë ky kufizim mund të behet me ligje të caktuara, pasi që mundësia e këtij kufizimi në përgjithësi është e parapare me paragrafin 2 të këtij neni të kësaj Konvente. Në këtë kontekst mundësia e kufizimit me ligj të lirisë së shprehjes është parapare edhe me paragrafin 2 të nenit 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por në rastin kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësisë në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare. Mundësia e korrigjimit të informacionit të pavërtetë, jo të plote ose të pasakte të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e tij, është e dhënë në këtë dispozitë por në pajtim me ligjin, e që në rastin konkret me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes sipas të cilit siç u elaborua më lart nuk janë plotësuar kushtet ligjore për lëshimin e një urdhërese gjyqësore për të ndaluar përhapjen e mëtejshme të informacionit etj.”.

51. Nga sa më sipër, lidhur me pretendimin për zbatimin e ligjit të gabuar, Gjykata vlerëson se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqiste argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin

shtruar hollësisht; dhe se, ne përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar ne tërësinë e tyre, ishin të drejta. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës ka gëzuar garancitë procedurale të ngërthiera në konceptin e gjykimit të drejte dhe të paanshëm (shih, mutatis mutandis, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI118/17, parashtues Sani Kervan dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih rastin Garcia Ruiz kundër Spanjës, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

52. Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (shih, mutatis mutandis, *Shub kundër Lituaniës*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

53. Rrjedhimisht, ky pretendim duhet të refuzohet qartazi i pabazuar.

Pretendimi për cenim të dinjitetit dhe të së drejtës për një gjykatë të paanshme

54. Gjykata vlerëson se pretendimet e lartpërmendura duhet të shqyrtohen së bashku.

55. Gjykata vëren se në rrethanat e rastit konkret është e qartë se objekt shqyrtimi në procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta është kërkesa e parashtuesit të kërkesës për caktimin e masës siguroese ndaj artikullit të portalit Insajder përkatësisht të heqjes së artikullit në fjalë. Gjykatat e rregullta nuk kanë vendosur për çështjen e cenimit të dinjitetit të parashtuesit të kërkesës karshi lirisë së shprehjes së portalit Insajder sepse ajo çështje nuk është iniciuar në procedurë nga parashtuesi i kërkesës. Është e vërtetë që gjykatat e rregullta në vendimet e tyre kanë përmendur çështjen e dinjitetit dhe lirisë së shprehjes mirëpo vetëm në kuadër të shqyrtimit të çështjes kryesore e që është vënia e masës së sigurisë përkatësisht heqja e artikullit të portalit Insajder.

56. Nga dokumentet e dorëzuara, çështjet e ngritura në procedurat në gjykatat e rregullta dhe objekti i shqyrtimit, rezulton se parashtuesi nuk ka iniciuar ndonjë procedurë në gjykatat e rregullta lidhur me pretendimin e tij nga nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] i Kushtetutës.

57. Në këtë situatë faktike lidhur me pretendimin për cenim të dinjitetit, Gjykata vlerëson se në pajtim me parimin e subsidiaritetit nuk mund ta vlerësojë kushtetutshmërinë e artikullit të portalit Insajder pa qenë i vlerësuar paraprakisht nga gjykatat e rregullta.

58. Rrjedhimisht, ky pretendim refuzohet për shqyrtim për shkak të mos shterimit të të gjitha mjeteve juridike siç përcaktohet me nenet 113 (7) të Kushtetutës, 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores.

59. Lidhur me pretendimin për cenim të së drejtës për një gjykatë të paanshme për shkak se i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Apelit ka gjykuar dy herë rastin e tij,

Gjykata vëren se pretendimi për njëanshmëri të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit është ngritur për herë të parë në Gjykatën Kushtetuese. Veç kësaj, Gjykata nuk vëren se procedura e zhvilluar në Gjykatën e Apelit ka qenë e njollosur nga arbitrariteti, sepse kjo e fundit, çështjen e parashtruesit njëherë e kishte kthyer për rigjykim tek gjykata e instancës më të ulët (shih Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.666/19, të 21 shkurtit 2019).

60. Gjykata thekson se në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata Kushtetuese nuk mund ta vlerësojë një pretendim apo një çështje që nuk është ngritur dhe vlerësuar paraprakisht nga gjykatat e rregullta (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI89/15, *Parashtrues Fatmir Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2016, paragrafi 35).
61. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat pranë gjykatave të rregullta, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo të korrigjohen shkeljet e tilla pasi ato të kenë ndodhur. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë mundësitë në procedurat pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese Nr. KI01/19, *Parashtrues Fatos Rizvanolli*, Aktvendim për Papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafi 99; dhe Nr. KI24/16, *Parashtrues Avdi Haziri*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39 dhe referencat e përmendura aty).
62. Veç kësaj, Gjykata vëren se në praktikën gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, parashtruesit nuk lirohen nga obligimi për ngritje të çështjeve tek gjykatat vendore, madje edhe në rastet kur gjykatat vendore kanë mundësi, apo janë të obliguara, ta shqyrtojnë rastin me vetë-iniciativë (*own motion*) në kuadër të të drejtave të mbrojtura me KEDNJ (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van Oosterwijk kundër Belgjikës*, Aktgjykim lidhur me mos shterim të mjeteve juridike, i 6 nëntorit 1980 dhe *Gaziyev kundër Azerbaixhanit*, Vendim i Pjesshëm për Pranueshmëri, i 8 shkurtit 2007).
63. Rrjedhimisht, edhe ky pretendim duhet të refuzohet për shqyrtim për shkak të mos shterjes në substancë në procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta.
64. Nga sa më sipër, kërkesa e parashtruesit të kërkesës në baza kushtetuese në tërësi duhet të refuzohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.(7) të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

65. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka vlerësuar se çështje kryesore që është gjykuar nga gjykatat e rregullta ka qenë caktimi i masës siguresë ndaj artikullit të portalit Insajder për çka parashtruesi i kërkesës ka pretenduar zbatim të ligjit të gabuar në dëm të tij. Këtë pretendim, Gjykata e refuzoi qartazi të pabazuar.

66. Lidhur me pretendimet për cenim të dinjitetit dhe të drejtës për një gjykatë të paanshme, Gjykata vlerësoi se për pretendimin për cenim të dinjitetit parashtruesi i kërkesës nuk ka filluar ndonjë procedurë në gjykatat e rregullta, kurse për pretendimin për gjykatë të paanshme, parashtruesi i kërkesës e kishte ngritur për herë të parë në procedurë në Gjykatën Kushtetuese. Të dyja këto pretendime u refuzuan për shqyrtim për shkak të mos shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me Kushtetutë.
67. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në baza kushtetuese dhe në tërësi u refuzua e papranueshme, siç përcaktohet në nenin 113.(7) të Kushtetutës, parashikohet me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe më tej specifikohet me rregullin 39 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (b) dhe (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 3 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arteta Rama-Hajrizi